



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

27.09.2022, Prishtinë,
Ref:18.07.2022\1288-2022

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Shkumbin Ahmetxhekaj, drejtor i përgjithshëm i RTK-së dhe Arsim Halili, zëvendës drejtor i përgjithshëm i RTK-së, kundër Kallxo.com, Gazeta Blic, Gazeta Express, Telegrafi, Insajderi, Paparaci, Reporterit, Gazeta Metro, Infokus, Botapress, Republika Post dhe Mekuli Press

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 21 shtator 2022, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Shkumbin Ahmetxhekaj, drejtor i përgjithshëm i RTK-së dhe Arsim Halili, zëvendës drejtor i përgjithshëm i RTK-së, kundër Kallxo.com, Gazeta Blic, Gazeta Express, Telegrafi, Insajderi, Paparaci, Reporterit, Gazeta Metro, Infokus, Botapress, Republika Post dhe Mekuli Press lidhur me publikimin e shkrimeve të ndara, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankuesi pretendon që mediat kanë publikuar shkrime të ndara, në të cilat nuk është raportuar e vërteta dhe, po ashtu, nuk është marr mendimi i palëve që kanë qenë të përmendura në shkrime. Ankesa pretendon se me lajmet e publikuara janë shkelë kapitujt II (raportimi i së vërtetës) dhe IV (e drejta për t'u përgjigjur) të Kodit të Mediave.

Lajmi është shkruar në portale të lajmeve dhe objekt i kësaj ankese është teksti i medias, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës, KMSHK gjen se ankesa është e pabazuar. Pra, nuk miratohet.

KMSHK pas leximit të ankesës dhe shkrimeve të mediave, për të cilat është paraqitur ankesa, gjen se mediat nuk kanë shkelë kapitullin II të Kodit të Mediave që ka të bëjë me raportimin e së vërtetës, pasi që mediat kanë publikuar një dokument publik dhe deklaratën e sindikatës së ankuesit. Mediat nuk kanë hulumtuar më tepër në lidhje me rastin, por kanë publikuar dokument të prodhuar nga institucionet. Ankuesit synojnë që nëpërmjet dokumentit që nuk janë nën hetime të argumentojnë që Prokuroria Speciale nuk ka rast të hapur ndaj tyre. Fakti që ankuesi paraqet si dëshmi vërtetimin se nuk është subjekt hetimi, nuk nënkupton se ndaj të njëjtit nuk ndërmerren veprime hetimore. Certifikata që një person nuk është nën hetime evidenton vetëm personat ndaj të cilëve është nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve. Në rastin konkret, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) nuk e ka mbyllur hetimin paraprak për faktin se nuk ka pasur prova, por për shkak se rasti veçse ka qenë duke u trajtuar në Prokurorinë Speciale. AKK thotë se rasti është mbyllur pasi ka hetim nga Prokuroria Speciale.

Në lidhje me ankesën për të drejtën për përgjigje, mediat i janë referuar dokumenteve publike mbi të cilat e kanë ndërtuar

raportimin. Kallxo.com i ka dërguar pyetje ankuesit, por nuk ka marrë përgjigje.

Andaj, KMSHK vendos që ankesa mos të miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës